



Datë: 27.03.2025
Numër Protokolli: 2274/2025

A.nr.198/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosje e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.198/2025 të datës 24.01.2025 të parashtruar nga ankuesja, F.R., kundër organit të punësimit/Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 27.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës **shpallet jo kompetent** për të shqyrtuar dhe vendosur lidhur me ankesën A.nr.198/2025 e datës 24.01.2025, të parashtruar nga ankuesja F.R.

A r s y e t i m

Ankuesja, F.R.(*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja*), me datë 24.01.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 519/2025, të regjistruar nën shenjë A.nr.198/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër rezultatit/njoftimit mbi kandidatët që kanë kaluar testin dhe ata që nuk kanë kaluar testin, lidhur me vertifikimin e avansuar të Prokurimit Publik.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.198/2025, të datës 24.01.2025, të parashtruar nga ankuesja, sepse:

Ankuesja, në ankesën e parashtruar në Këshill kundër Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, pretendon se pyetja 3, 5 dhe 15 kanë qenë të formuluar gabimisht, gjë që ka ndikuar në penalizimin për arritjen e pikëve të kalueshmërisë, andaj e njëjta kërkon që pas shqyrtimit ankesa e saj të aprovohet dhe të ndryshohet raporti i renditjes së kandidatëve të sukseshëm me udhëzimin që hartohet ri-renditja e kandidatëve sipas përqindrjes së saktësisë së pyetjeve duke larguar nga llogaritja 3 pyetjet kontestuese ose që të Udhëzohet Komisioni i testeve që të organizojë ri-testimin për ankuesen.

Kolegji Këshillit në kuptim të pranueshmërisë së ankesës ju referua dispozitave Ligjit Nr. 05/l-092 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/l-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/l- 237 dhe me ligjin nr. 05/l-068, përkatësisht nenit 25,

paragrafi 1,2,3,4 5 dhe neni 8 ku përcaktohet se; 1. KRPP-ja është përgjegjëse për zhvillimin e moduleve të trajnimit dhe kurrikulës për kualifikimet në prokurim. KRPP-ja duhet të identifikojë personat, me përvojë në prokurimin publik, të përshtatshëm për mësimdhënie në kurset e prokurimit të hartuara nga KRPP-ja. KRPP-ja në bashkëpunim me IKAP-in duhet të aranzhojnë zhvillimin dhe mbajtjen e kurseve profesionale të prokurimit me kohëzgjatje të paktën pesëmbëdhjetë (15) ditë për trajnime bazike dhe dhjetë (10) ditë për trajnime të avancuara. KRPP-ja siguronë që kurse të tilla të përgatiten dhe mbahen nga një person i trajnuar ose Institucion i trajnimeve që ka ekspertizë substanciale në praktikat më të mirandërkombëtare të prokurimit dhe në sistemin e prokurimit të BE-së. 2. KRPP-ja në bashkëpunim me IKAP-in do të jenë përgjegjës për organizimin e provimeve. 3. Çdo person i interesuar mund të marrë pjesë në trajnimin profesional të prokurimit. Autoriteti Kontraktues duhet që në lidhje me Zyrtarët e Prokurimit të punësuar të trajtojë kohën e shpenzuar nga Zyrtari i Prokurimit në trajnim si orar të zakonshëm pune dhe ta kompensojë atë njëllë sikurse të kishte shpenzuar atë kohë në punë. Autoriteti kontraktues po ashtu mund t'i ofrojë personit në fjalë, në pajtim me aktet e zbatueshme ligjore dhe nën-ligjore edhe kompensim për shpenzimet që domosdoshmërisht janë bërë nga personi për pjesëmarrjen në trajnim. 4. KRPP-ja në bashkëpunim me IKAP-in do të lëshojnë “certifikatën themelore profesionale të prokurimit” vetëm për personat të cilët i kanë përfunduar në mënyrë të kënaqshme të gjitha kurset themelore dhe të cilët rekomandohen nga trajnuesi. KRPP-ja në bashkëpunim me IKAP-in do të lëshojnë “certifikatën e avancuar profesionale të prokurimit” vetëm për personat të cilët i kanë përfunduar në mënyrë të kënaqshme të gjitha kurset e avancuara. 5. Certifikatat themelore profesionale të prokurimit janë të vlefshme për tri (3) vite nëse nuk anulohen më herët në pajtim me paragrafin 8. të këtij neni. Personi i cili mban një certifikatë themelore të prokurimit dhe i cili nuk arrin të marrë certifikatën e avancuar brenda kësaj periudhe tri (3) vjeçare e humb të drejtën për të shërbyer si Zyrtar përgjegjës i Prokurimit përderisa ai/ajo të marrë certifikatën e avancuar. Certifikatat e avancuara kanë validitet të përhershëm dhe në rast se KRPP-ja organizon trajnime bartësit e tyre janë të obliguar që të ndjekin trajnimet. 8. Çdo certifikatë e prokurimit e lëshuar nga KRPP-ja ose IKAP-i mund të anulohet nga KRPP-ja nëse konstatohet se personi i cili e posedon atë certifikatë nuk i plotëson ose më nuk i plotëson kushtet e kualifikimit të përcaktuara në nenin 23 të këtij ligji ose ka bërë një shkelje të rëndë të këtij ligji ose të rregullave të prokurimit. Nëse poseduesi i certifikatës është nëpunës civil, procesi i anulimit duhet të bëhet në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit për Shërbimin Civil. Nëse poseduesi i certifikatës nuk është nëpunës civil, KRPP-ja duhet ti dërgojë këtij personi një njoftim paraprak me shkrim prej nëntëdhjetë (90) ditëve për qëllimin e anulimit të certifikatës së tij/saj; ky njoftim i jep personit në fjalë të drejtën e ankesës sipas Ligjit për Procedurën Administrative. Nëse pas përfundimit të procedurës së ankesës sipas Ligjit për Procedurën Administrative, personi në fjalë është i pakënaqur me rezultatin, atëherë ai mund të ankohet për anulimin e certifikatës në Gjykatën Themelore – Departamenti për çështje administrative. Pas periudhës një vjeçare zyrtari në fjalë mund të fillojë trajnimin bazik, prandaj bazuar në përcaktimet ligjore si me lartë, Kolegji i Këshillit konstaton se nuk ka kompetencë për ti shqyrtuar perëndimet ankimore të ankueses lidhur certifikimin avancuar për Prokurim Publik.

Andaj, sipas dispozitave të nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e parashtuara nga nëpunësit civil dhe kandidatët për pranim në Shërbimin Civil të Kosovës, rrjedhimisht Kolegji vendosi që të shpallë veten jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.198/2025, e datës 24.01.2025, të parashtuar nga ankuesja.

Bazuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.198/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses F.R.;
- Udhëheqëses së Personelit në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik; si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.